



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 DOKUMENTI ËSHTË I PRAVNOSNAŽIJA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC

25-05 2017

P.nr.644/16

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me procesmbajtësen juridike Miranda Krasniqi Jashari, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED] i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.623-2/15, të dt.07.07.2016, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.623-2/15, të dt.07.07.2016 për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.21.03.2017 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.623-2/15, të dt.07.07.2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED], nga fshati [REDACTED], Komuna e Ferizajit, i lindur me [REDACTED], në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, e gjendjes se varfër ekonomike, me nr personal të letërnjoftimit [REDACTED] mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Se me datën 19.04.2015 reth orës 17.00, në rrugën magjistrale Ferizaj-Shtime, në fshatin Lloshkobare, Komuna e Ferizajit përkatësisht te N.T.P, “[REDACTED]”, duke drejtuar automjetin e markës “Renault Escape”, me targa të regjistrimit [REDACTED], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 42/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, fillon kyqjen, pa u bindur se një veprim mund të bëjë në mënyrë të sigurtë pa i penguar pjesëmarrësit në komunikacion me të cilin rast goditet motoçiklistin [REDACTED] i cili ishte duke qarkulluar në relacionin Ferizaj –Shtime, me të cilin rast pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson [REDACTED], lëndime të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore,-

-me të cilën ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e Ferizajit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.623-2/15, të dt.07.07.2016 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.623-2/15, të dt.07.07.2016, me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: konstatimi i ekspertit mjeko ligjor i datës 27.02.2016, mendimi i ekspertit të komunikacionit i datës 10.10.2015, deklarata e të pandehurit e datës 19.04.2015, deklarata e të dëmtuarit e datës 19.04.2015 si dhe fotografitë në shkresat e lëndëve , vërteton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Konform nenit 458,459 dhe 460 I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.644/16 datë 22.03.2017

Procesmbajtëse

Miranda Krasniqi Jashari

Gjyqtarja Individuale

Hakile Hazi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimin të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.